667/16

06.07.2016

REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI

Në pajtim me nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale nr. 03/L-040 dhe nenin 44 pika 3 të Ligjit për Mbrojtje nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë tjera nr. 04/L-027, nenin 67 "f" dhe "g" të Statutit të komunës, si dhe me qëllim të realizimit të "Ushtrimit Fushor tre ditor 06,07,08.07.2016 – Veprimi i Shpejtë" në partneritet me Forcon e Sigurisë së Kosovës dhe KFOR-in, me datën 06.07.2016, Kryetari i Komunës merr këtë:

VENDIM
PËR NGRITJE TË QENDRËS OPERATIVE EMERGJENTE LOKALE NË KOMUNËN E VUSHTRRISË

1. Me këtë vendim ngritët Qendra Emergjente e Komunës me këtë përbërje:

   **1.1 Bajram Mulaku,** Komandant i Qendrës
   **1.2 Nezir Klinaku,** anëtar
   **1.3 Behram Rrahmani,** DMSH, anëtar
   **1.4 Mustafa Xhoni,** DMSH, anëtar,
   1.5 **Gani Imeri,** DSHP, anëtar,
   1.6 **Gëzim Saraqi,** DI, anëtar,
   **1.7 Xhevrije Rama,** DAdmin. anëtare,
   **1.8 Shpresa Rama,** DKRS, anëtare,
   1.9 **Fadil Muzaqi,** DProk. anëtar,
   1.10 **Isuf Jashari,** DFin. Anëtar,
   1.11 **Musaj Tërbunja,** DA, anëtar,
   1.12 **Arta Haxhaj,** DEZH, anëtare,
   **1.13** **Sami Istrefi,** DUMM, anëtar,
   1.14 **Bedri Dobra,** DKadas. Anëtar,
   1.15 **Skender Hoxha,** Shef i Emergjences, anëtar
   **1.16** **Bajram Beqiri,** Zyrtar i DMSH, anëtar,
   **1.17** **Islam Latifi,** DSHP anëtar
   **1.18** **Albanez Tahiraj,** ZL anëtar
   **1.19** **Fatmir Feka,** DA anëtar,
   1.20 **Agim Miftari,** DKA anëtar,
   1.21 **Blerim Zhabari,** ZMedia, anëtar,
   1.22 **Fadil Hyseni,** NJZ, anëtar,

**1.23** **Kumrije Zhabari,** Kruqi i Kuq, anëtare,
**1.24** **Muhamet Alidemaj,** PK, anëtar,
1.25 **Shemsedin Preteni,** Zëdhënës, anëtar.
1.26 **Rafet Ahmeti,** përfaqësuesi i KEDS-it,
1.27 **Hysni Shabani,** përfaqësues i Kompanisë "Hysnia"
1.28 **Nexhat Feka** përfaqësues i Ujësjellësit, Njësia në Vushtrri

2. Qendra Emergjente do të përcjellë 24 orë situatën në terren dhe koordinoj punët dhe veprimet e tij përmes zyrës komunale për lajmërim, të bashkëpunoj me Policinë e Kosovës, akter tjerë të ndërlidhur në këtë ushtrim fushorë.

3. Drejtorët e drejtorive komunale duhet të ofrojnë mbështetjen e duhur për Qendrën apo ekipet në terren gjatë gjithë kohës sa zgjat gjendja e emergjente si dhe të i kenë në dispozicion në çdo moment të hapur telefonat mobil.

4. Zyra për informim të komunës të përcjell situatën në terren dhe sipas nevojës informoj me kohë qytetarët lidhur me gjendjen në terren për të përballuar sa më lehtë dhe pa pasoja situatat emergjente.

5. Vendimi hyn në fuqi menjëherë.

Kryetari i Komunës

Bajram Mulaku

668/16
-1-
Datë / Datum 06.07.2016
VUSHTRRI - VUČITRN

REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI

Në pajtim me nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale nr. 03/L-040 dhe nenin 44 pika 3 të Ligjit për Mbrojtje nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë tjera nr. 04/L-027, nenin 67 "f" dhe "g" të Statutit të komunës, si dhe bazuar në vendimin 02nr.667/16, dt.06.07.2016, Kryetari i Komunës merr këtë:

# VENDIM

1. Ngritet gatishmëria mergjente dhe aktivizohet Qendra Lokale Emergjente në Komunën e Vushtrrisë.
2. Pas marrjes së informacioneve lidhur me gjendjen e krijuar në Fabrikën e Llamarinës gjegjësisht shkaktimit të vërshimeve, zjarrit dhe personave të ngujuar, Qendra Lokale Emergjente dislokohet në ambiente të sigurta të kësaj fabrike për marrje të masave dhe veprimeve konform situatës së krijuar.
3. Me këtë vendim njoftohen: Qendra Lokale Emergjente, Zyra për informim.
4. Vendimi hyn në fuqi menjëherë.

Kryetari i Komunës

Bajram Mulaku

669/16

06.07.2016

REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI

Në pajtim me nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale nr. 03/L-040 dhe nenin 91 paragrafi 1 pika 3 të Ligjit për Mbrojtje nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë tjera nr. 04/L-027, nenin 67 "f" dhe "g" të Statutit të komunës, si dhe bazuar në Rekomandimin e Drejtorit për Mbrojtje dhe Shpëtim dt. 06.07.2016, përkatësisht situatës emergjente të krijuar në Fabrikën e Llamarines, Kryetari i Komunës merr këtë:

VENDIM

1. Z. Behram Rrahmani, anëtar i Qendrës Lokale Emergjente emërohet **Komandant i Incidentit** në Fabrikën e Llamarinës në Vushtrri.
2. I lartpërmenduri do të i ushtroj kompetencat dhe përgjegjësitë e tij në pajtim me situatën e krijuar dhe ligjet në fuqi.
3. Me këtë vendim njoftohen: të gjitha strukturat e përfshira në këtë ushtrim fushorë.
4. Vendimi hyn në fuqi menjëherë.

Kryetari i Komunës

Bajram Mulaku

672/16

06.07.2016

REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI

Kryetari

Bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, dhe nenin 67 "f" dhe "g" të Statutit të Komunës, Kryetari i Komunës merr këtë:

# V E N D I M

## PËR FORMIM TË KOMISIONIT

1. Formohet komisioni për hartim të Draft Rregullores për Tatimin mbi Pronën e Paluajtshme në Komunën e Vushtrrisë për v. 2017, në këtë përbërje:

   1.1 Xhylsime Feka, kryesuese e komisionit
   1.2 Bedri Kostanica, anëtar
   1.3 Mexhit Perquku, anëtar
   1.4 Besim Muzaqi, anëtar
   1.5 Ajet Gërgjaliu, anëtar

2. Komisioni në përbërje të cekur si në pikën paraprake do të hartoj Draftin Rregullores për Tatimin mbi Pronën e Paluajtshme në Komunën e Vushtrrisë për v. 2017 konform legjislacionit në fuqi dhe dorëzoj në Sekretarinë e KK-së për procedim në KPF dhe KK në mbledhjen e muajit korrik 2016 ku do të bëhet shqyrtimi i parë.

3. Afati i fundit për dërgim në Sekretari të KK-së është data 11.07.2016.

4. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

5. Vendimi iu dërgohet të lartpërmendurve dhe arkivit të sekretarisë.

Kryetari i Komunës

Bajram Mulaku

673/16
-1-
06.07.2016

REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI

Kryetari

Bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, nenin 67, "g" të Statutit të Komunës, Kryetari i Komunës merr këtë:

# VENDIM

1. Me këtë vendim, caktohen zyrtarët kontaktues të komunës për raportim lidhur me performancën e komunës, në këtë përbërje:

    1.1 **Islam Latifi,** koordinator, (Drejtoria e Shërbimeve Publike),
    1.2 **Shqipe Gashi,** (Drejtoria e Shërbimeve Publike),
    1.3 **Arben Mlinaku,** (Drejtoria e Shërbimeve Publike),
    1.4 **Ardi Ukshini,** (Drejtoria për Urbanizëm),
    1.5 **Liridon Lahu,** (Drejtoria për Administratë),
    1.6 **Behram Rrahmani,**(Drejtoria opër Mbrojtje dhe Shpëtim),
    1.7 **Haki Bunjaku,**(Drejtoria për Inspektime),
    1.8 **Naim Ferizi,**(Drejtoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale),
    1.9 **Blerim Zhabari,** (Zyra për Informim),
    1.10 **Bujar Klinaku**, (Sekretaria e KK-së),
    1.11 **Remzije Zekolli**, (Njësia për Barazi Gjinore dhe të Drejtat e Njeriut),
    1.12 **Liridon Hajdini**, (Drejtoria për Kulturë Rini dhe Sport),
    1.13 **Idriz Ismajli,** (Zyra e Kryetarit),
    1.14 **Xhafer Islami**, (Drejtoria e Prokurimit),
    1.15 **Ragip Mikushnica,** (KRM "Uniteti" – Njësia në Vushtrri),
    1.16 **Faton Verbovci**, (KRU "Ujësjellësi" – Njësia në Vushtrri).

2. Zyrtarët e cekur në pikën paraprake, secili nga fusha respektive do të mbledhë verifikoj dhe raportoj të dhënat e sakta te koordinatori, në bazë të sistemit të rishikuar të menaxhimit të performancës në fushat të cilat janë pjesë e këtij sistemi. Para fillimit të mbledhjes së të dhënave këta zyrtar do të marrin udhëzime nga koordinatori për mënyrën e mbledhjes verifikimit dhe raportimit, si dhe do të kërkojnë sqarime shtesë në rast të ndonjë paqartësie.

3. Të dhënat sipas pikës paraprake përfshijnë:

    3.1 Të dhënat për disa shërbime që i ofron komuna për fusha të caktuara raportohen për periudhën kohore 6 mujore dhe 1 vjeçare.

3.2 Të dhënat për shërbimet tjera specifike që i ofron komuna kërkohet të raportohen në mënyrë kumulative.

4. Afati për dërgimin e të dhënave do të përcaktohet nga MAPL.

5. Zyrtarët komunal nga pika 1 (një) e këtij vendimi do t'i kryejnë me kohë dhe përgjegjësi obligimet e përcaktuara me këtë vendim. Të dhënat e raportuara do të jenë pjesë e auditimit nga Zyra e Auditori i Përgjithshëm.

6. Koordinatori komunal do t'i kryej të gjitha obligimet sipas "Udhëzuesit të MAPL-së për procesin e mbledhjes, verifikimit dhe raportimit të të dhënave për sistemin e menaxhimit të performancës në komuna" dhe dokumenteve tjera relevante të lidhura me sistemin e rishikuar të menaxhimit të performancës komunale.

7. Drejtorët komunal përkatësisht përgjegjësit sektorial kanë gjithashtu përgjegjësi për mbarëvajtje të procesit të raportimit brenda drejtorisë – sektorit, duke siguruar saktësinë e të dhënave për raportim.

8. Drejtoria e administratës ka rol të veçantë në lehtësimin e komunikimit në mes të drejtorive dhe zyrtarëve komunal për raportim.

9. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

10. Vendimi ju dërgohet: Drejtorëve të drejtorive, përgjegjësve sektorial, zyrtarëve nga pika 1 (një) e këtij vendimi dhe Arkivit të Sekretarisë.

Kryetari i Komunës

Bajram Mulaku

675/16
-1-
08.07.2016

REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI

Kryetari

Bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, nenin 67, "g" të Statutit të Komunës, si dhe në bazë të propozimit të Drejtorisë për Ekonomi bujqësi pylltari dhe zhvillim rural nr.09-164-32951, datë 07.07.2016, Kryetari i Komunës merr këtë:

# VENDIM

## PËR FORMIM TË SHTABIT KOMUNAL PËR KORRJE-SHIRJE

1. Me këtë vendim formohet shtabi i komunës për korrje-shirje në këtë përbërje:

   1.1 Arta Haxhaj, kryesuese e shtabit (Drejtoreshë për EBPZHR)
   1.2 Behram Rrahmani, anëtar (Drejtoria për mbrojtje dhe shpëtim)
   1.3 Rabije Zahiti, anëtare (DEBPZHR, agronome)
   1.4 Nexhmi Cakaj, anëtar (DEBPZHR, ekonomist)
   1.5 Berat Jonuzi, anëtar (DEBPZHR, jurist)

2. Detyrë e shtabit komunal për korrje shirje është që të përcjell mbarëvajtjen e fushatës së korrje shirjeve në territorin e komunës së Vushtrrisë si dhe të hartoj raport me shkrim për organet kompetente lidhur me përfundimin e fushatës si dhe rendimentet e arritura nga korrje shirjet.

3. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

4. Vendimi i dërgohet: Drejtoreshës për ekonomi bujqësi pylltari dhe zhvillim rural, anëtarëve të shtabit dhe arkivit të sekretarisë.

Kryetari i Komunës

Bajram Mulaku

676/16
-1-
11.07.2016

REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA VUSHTRRI

Bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040 dhe nenit 67 “g” të Statutit të Komunës, si dhe në bazë të Propozimit të Drejtorisë për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale 07 Nr.176 të dt. 07.07.2016, Kryetari i Komunës merr:

# VENDIM

1. znj.Arjeta Gërguri nga Fshati Studime e Epërme, Komuna e Vushtrrisë, i lejohet një ndihmë financiare në shumë prej 500 € (pesëqind euro) për shkak të kushteve të rënda ekonomike e sociale dhe gjendjes së rëndë shëndetësore të djalit të saj, i cili ka nevojë për terapi të mëtutjeshme

2 Shuma e mjeteve të cekura si në pikën paraprake të këtij vendimi duhet të paguhet nga buxheti i Zyrës së Kryetarit të Komunës– subvencione për raste të veçanta.

3 znj.Arjeta Gërguri apo i autorizuari i saj ligjorë duhet të ofroj kopjen e dokumentit të identifikimit dhe të kartelës bankare në Drejtorinë për Buxhet dhe Financa në Vushtrri me qëllim të implementimit të këtij vendimi.

4 Zbatimin e këtij vendimi do ta bëjë Zyra e kryetarit dhe Drejtoria për Buxhet dhe financa në Vushtrri.

5 Nga një kopje e këtij vendimi t’i dërgohet Zyrës së Kryetarit të Komunës, Drejtorisë për buxhet dhe Financa, një kopje palës dhe një kopje të ruhet në dosje.

Kryetari i Komunës

Bajram Mulaku

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E VUSHTRRISË-OPŠTINA VUČITRN
02 Nr. / Br 677/16
Nr. i fq. / Br. st -1-
Data: / Datum 11.07.2016
VUSHTRRI - VUČITRN

REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI

Kryetari

Bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, nenin 67 "g" të Statutit të Komunës, Kryetari i Komunës merr këtë:

# V E N D I M

1. Lejohet pagesa e faturës nr. 0246158, dt. 08.07.2016, në shumë prej 17.00 € (shtatëmbëdhjetë euro), për shpenzime të krijuara (pije freskuese) me oficer të Forcës së Sigurisë së Kosovës, në NPH "6 Vëllezërit Istrefi" në Vushtrri.
2. Pagesa të bëhet nga buxheti i Zyrës së Kryetarit të Komunës në numër të llogarisë bankare të paraqitur në faturë e cila është e bashkëngjitur në shtojcë të këtij vendimi.
3. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Buxhet dhe Financa.
4. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.
5. Vendimi ju dërgohet: Drejtorisë për Buxhet dhe Financa dhe Arkivit të Sekretarisë.

Kryetari i Komunës

Bajram Mulaku

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E VUSHTRRISË-OPŠTINA VUČITRN
02 Nr. / Br 684/16
Nr. i fq. / Br. st -1-
Data: / Datum 12.07.2016
VUSHTRRI - VUČITRN

REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI

Kryetari

Bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, nenin 67, "g" të Statutit të Komunës, si dhe në bazë të propozimit të Drejtorisë për Shërbime Publike datë 12.07.2016, Kryetari i Komunës merr këtë:

# V E N D I M

1. Për nevoja të Drejtorisë për Shërbime Publike, lejohet shfrytëzimi i mjetit motorik (traktorit) si dhe shoferit, i cili është në menaxhim të Drejtorisë për Arsim në Vushtrri, për muajt korrik-tetor 2016, për ujitje të sipërfaqeve të gjelbëruara publike në Vushtrri.

2. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen: Drejtori për Arsim dhe Drejtori për Shërbime Publike në Vushtrri.

3. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

4. Vendimi ju dërgohet: Drejtorit për Arsim, Drejtorit për Shërbime Publike dhe Arkivit të Sekretarisë.

Kryetari i Komunës

Bajram Mulaku

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E VUSHTRRISË-OPŠTINA VUČITRN
02 Nr. / Br 689/16
Nr. i fq. / Br. st -1-
Data: / Datum 14.07.2016
VUSHTRRI - VUČITRN

REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA VUSHTRRI

Bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040 dhe nenit 67 "g" të Statutit të Komunës, si dhe në bazë të Propozimit 07.Nr.183 të dt. 11.07.2016 të Drejtorisë për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale, Kryetari i Komunës merr:

# VENDIM

1. z.Fitim Klinaku nga Komuna e Vushtrrisë, i lejohet një ndihmë financiare në shumë prej 250 € (dyqind e pesëdhjetë euro) për shkak të kushteve të rënda ekonomike e sociale dhe gjendjes së rëndë shëndetësore të tij.

2. Shuma e mjeteve të cekura si në pikën paraprake të këtij vendimi duhet të paguhet nga buxheti i komunës – fondi për transfere dhe subvencione.

3. z.Fitim Klinaku apo i autorizuari i tij ligjor duhet të ofroj kopjen e dokumentit të identifikimit dhe të kartelës bankare në Drejtorinë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale në Vushtrri me qëllim të implementimit të këtij vendimi.

4. Zbatimin e këtij vendimi do ta bëjë Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale dhe Drejtoria për Buxhet dhe financa në Vushtrri.

5. Nga një kopje e këtij vendimi t'i dërgohet drejtorive të cekura në pikën 4, një kopje palës dhe një kopje të ruhet në dosje.

Kryetari i Komunës

Bajram Mulaku

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E VUSHTRRISË-OPŠTINA VUČITRN
02 Nr./Br 690/16
Nr.i fq./Br. st -1-
Data:/Datum 14.07.2016
VUSHTRRI - VUČITRN

REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA VUSHTRRI

Bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040 dhe nenit 67 "g" të Statutit të Komunës, si dhe në bazë të Propozimit 10.Nr.559/16 të dt. 13.07.2016 të Drejtorisë Komunale për Arsim, Kryetari i Komunës merr:

# VENDIM

1. Shoqatës së Pedagogëve të Kulturës Fizike dhe Sportit Shkollor - Vushtrri i lejohet një ndihmë financiare në shumë prej 500 € (pesëqind euro) për mbështetje financiare për mbulimin e shpenzimeve rekreative në shenjë mirënjohje për rezultatet e arritura në garat republikane, ku janë përfaqësuar 11 ekipe në sporte të ndryshme, ku janë shënuar këto rezultate: 5 vende të para dhe një vende i dytë.

2. Shuma e mjeteve të cekura si në pikën paraprake të këtij vendimi duhet të paguhet nga buxheti i komunës – fondi për transfere dhe subvencione nga DKA-ja.

3. Shoqata e Pedagogëve të Kulturës Fizike dhe Sporti shkollor - Vushtrri apo i autorizuari ligjorë duhet të ofroj kopjen e dokumentit të identifikimit dhe të kartelës bankare në Drejtorinë Komunale për Arsim në Vushtrri me qëllim të implementimit të këtij vendimi.

4. Zbatimin e këtij vendimi do ta bëjë Drejtoria Komunale për Arsim dhe Drejtoria për Buxhet dhe financa në Vushtrri.

5. Nga një kopje e këtij vendimi t'i dërgohet drejtorive të cekura në pikën 4, një kopje palës dhe një kopje të ruhet në dosje.

Kryetari i Komunës

Bajram Mulaku

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E VUSHTRRISË-OPŠTINA VUČITRN
02 Nr./Br. 691/16
Nr. i fq./Br. st. -1-
Data:/Datum 14.07.2016
VUSHTRRI - VUČITRN

REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA VUSHTRRI

Bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040 dhe nenit 67 "g" të Statutit të Komunës, si dhe në bazë të Propozimit 10.Nr.560/16 të dt. 13.07.2016 të Drejtorisë Komunale për Arsim, Kryetari i Komunës merr:

# VENDIM

1. z.Blendian Salihu nga Komuna e Vushtrrisë, student në Fakultetin e Arqitekturës, i lejohet një ndihmë financiare në shumë prej 480 € (katërqind e tetëdhjetë euro) për mbulimin e shpenzimeve për pjesëmarrje në Workshopin e "MEDS" që do të mbahet në Bukuresht të Rumanisë nga dt.1-16 gusht 2016. Punëtoria ka për qëllim zgjerimin e njohurive duke iniciuar bashkëpunimin në mes të studentëve që zotërojnë njohuri nga lëmi të ndryshme kulturore dhe profesionale.

2. Shuma e mjeteve të cekura si në pikën paraprake të këtij vendimi duhet të paguhet nga buxheti i komunës – fondi për transfere dhe subvencione nga DKA-ja.

3. z.Blendian Salihu apo i autorizuari i tij ligjorë duhet të ofroj kopjen e dokumentit të identifikimit dhe të kartelës bankare në Drejtorinë Komunale për Arsim në Vushtrri me qëllim të implementimit të këtij vendimi.

4. Zbatimin e këtij vendimi do ta bëjë Drejtoria Komunale për Arsim dhe Drejtoria për Buxhet dhe financa në Vushtrri.

5. Nga një kopje e këtij vendimi t'i dërgohet drejtorive të cekura në pikën 4, një kopje palës dhe një kopje të ruhet në dosje.

Kryetari i Komunës

Bajram Mulaku

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E VUSHTRRISË-OPŠTINA VUČITRN
02 Nr./Br. 693/16
Nr i fq./Br. st. -2-
Data:/Datum 14.07.2016
VUSHTRRI - VUČITRN

REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI

Kryetari

Bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, nenin 67, "g" të Statutit të Komunës, si dhe në bazë të kërkesës së Drejtorisë për Kulturë Rini dhe Sport dt.14.07.2016, Kryetari i Komunës merr këtë:

# VENDIM

1. Lejohet shtruarja e një dreke me ushqim tradicional në vlerë deri në 195.00 € (njëqindenëntëdhjetepesë euro), për pjesëmarrës të aktivitetit "Ditët e Diasporës" ku do të mbahet Orë Letrare. Ky aktivitet do të mbahet në Kalanë e Vushtrrisë me datën 15.07.2016.

2. Pagesa e këtyre shpenzimeve të bëhet nga buxheti i Drejtorisë për Kulturë Rini dhe Sport.

3. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen: Drejtoria për Kulturë Rini dhe Sport dhe Drejtoria për Buxhet dhe financa në Vushtrri.

4. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

5. Vendimi ju dërgohet: Drejtorisë për Kulturë Rini dhe Sport, Drejtorisë për Buxhet dhe Financa në Vushtrri dhe Arkivit të Sekretarisë.

Kryetari i Komunës

Bajram Mulaku

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E VUSHTRRISË-OPŠTINA VUČITRN
02 Nr./Br. 694/16
Nr. Faq./Br. st. - 3 -
Data:/Datum 14.07.2016
VUSHTRRI - VUČITRN

REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI

Kryetari

Bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, nenin 67 "g" të Statutit të Komunës, Kryetari i Komunës merr këtë:

# VENDIM

1. Lejohet pagesa e faturës nr. 0004952, dt. 06.07.2016, në shumë prej 126.00 € (njëqindenjëzetegjashtë euro), për shpenzime të krijuara në DP. Qebaptore "Biti" në Vushtrri – drekë (ushqim nga skara) për pjesëmarrës të ushtrimit fushor (zyrtar të komunës dhe Forcës së Sigurisë së Kosovës), mbajtur në ambientet e fabrikës së llamarinës me datën 06.07.2016.

2. Pagesa të bëhet nga buxheti i Zyrës së Kryetarit të Komunës në numër të llogarisë bankare të paraqitur në faturë e cila është e bashkëngjitur në shtojcë të këtij vendimi.

3. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Buxhet dhe Financa.

4. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

5. Vendimi ju dërgohet: Drejtorisë për Buxhet dhe Financa dhe Arkivit të Sekretarisë.

Kryetari i Komunës

Bajram Mulaku

REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI

Kryetari

Bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, dhe nenin 67 "f" dhe "g" të Statutit të Komunës, si dhe në kërkesë të USAID-it dt. 18.07.2016, Kryetari i Komunës merr këtë:

# V E N D I M
## PËR FORM TË KOMISIONIUT PËR PRANIM TEKNIK

1. Formohet komisioni për pranim teknik të dy E-kiosqeve në qytet, në këtë përbërje:

   1.1 **Liridon Lahu,** kryesues i komisionit
   1.2 **Bekim Selmani**, anëtar
   1.3 **Idriz Ismajli**, anëtar

2. Komisioni në përbërje të cekur si në pikën paraprake obligohet që të zbatoj procedurat për pranim teknik të E-kioskut i cili gjendet në ambientet e hyrjes së objektit të komunës si dhe E- kioskut në ambientet e objektit të Qendrës për Regjistrim Civil në Vushtrri. Pas pranimit teknik komisioni do të hartoj raport me shkrim për organin kompetent.

3. Përfaqësuesi i USAID-it do të jetë prezent në cilësi të vëzhguesit me rastin e pranimit teknik.

4. Pranimi teknik bëhet me datën 19.07.2016, në ora 10;00.

5. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

6. Vendimi iu dërgohet: Përfaqësuesit të USAID-it, të lartpërmendurve dhe arkivit të sekretarisë.

Kryetari i Komunës

Bajram Mulaku

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E VUSHTRRISË-OPŠTINA VUČITRN
02 Nr./Br. 719/16
Nr. i fq./Broj st. -1-
Datat/Datum 19.07.2016
VUSHTRRI - VUČITRN

REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA VUSHTRRI

Bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040 dhe nenit 67 "g" të Statutit të Komunës, si dhe në bazë të Propozimit 07 Nr.186 të dt. 15.07.2016 të Drejtorisë për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale, Kryetari i Komunës merr:

# V E N D I M

1. Znj.Arbenita Mehmeti nga Komuna e Vushtrrisë, i lejohet një ndihmë financiare në shumë prej 250 € (dyqind e pesëdhjetë euro) për mbulimin e shpenzimeve të varrimit për nënën e saj, për shkak të kushteve të rënda ekonomike e sociale.

2 Shuma e mjeteve të cekura si në pikën paraprake të këtij vendimi duhet të paguhet nga buxheti i Zyrës së Kryetarit të Komunës– subvencione për raste të veçanta.

3 Znj.Arbenita Mehmeti apo i autorizuari i saj ligjorë duhet të ofroj kopjen e dokumentit të identifikimit dhe të kartelës bankare në Drejtorinë për Buxhet dhe Financa në Vushtrri me qëllim të implementimit të këtij vendimi.

4 Zbatimin e këtij vendimi do ta bëjë Zyra e kryetarit dhe Drejtoria për Buxhet dhe financa në Vushtrri.

5 Nga një kopje e këtij vendimi t'i dërgohet Zyrës së Kryetarit të Komunës, Drejtorisë për buxhet dhe Financa, një kopje palës dhe një kopje të ruhet në dosje.

Kryetari i Komunës

Bajram Mulaku

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E VUSHTRRISË - OPŠTINA VUČITRN
02 Nr. / Br 722/16
Nr. i fq. / Br. st
Data: / Datum 20.07.2016
VUSHTRRI - VUČITRN

REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI

Kryetari

Bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 dhe nenin 67, "g" të Statutit të Komunës, si dhe në bazë të ftesës së BE – Këshilli i Evropës dt. 30.06.2016, Kryetari i Komunës merr këtë:

# V E N D I M

1. Z. **Ekrem Merovci**, zyrtar i komunës, i lejohet pagesa e mëditjes për udhëtim zyrtar në Beograd nga data12-15 korrik 2016, pjesëmarrje në trajnim nga Këshilli i Evropës, lidhur me temën "Pjesëmarrja e komuniteteve në procesin e vendimmarrjes në komunë".

2. Pagesa e mëditjes të bëhet nga buxheti i Zyrës Lokale të Komuniteteve.

3. Ftesa dhe agjenda për pjesëmarrje në trajnim është e bashkëngjitur në shtojcë të këtij vendimi.

4. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Buxhet dhe Financa.

5. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

6. Vendimi i dërgohet: Drejtorisë për buxhet dhe financa dhe arkivit të sekretarisë.

Kryetari i Komunës

Bajram Mulaku

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E VUSHTRRISË-OPŠTINA VUČITRN
01 Nr./ Br. 723/16
Nr. i fq. / Br. st.
Data: / Datum 20.07.2016
VUSHTRRI - VUČITRN

REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI

Kryetari

Bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 dhe nenin 67, "g" të Statutit të Komunës, si dhe në bazë të ftesës së BE – Këshilli i Evropës dt. 30.06.2016, Kryetari i Komunës merr këtë:

# V E N D I M

1. Z. **Xhavit Mehmeti**, zyrtar i komunës, i lejohet pagesa e mëditjes për udhëtim zyrtar në Beograd nga data12-15 korrik 2016, pjesëmarrje në trajnim nga Këshilli i Evropës, lidhur me temën "Pjesëmarrja e komuniteteve në procesin e vendimmarrjes në komunë".

2. Pagesa e mëditjes të bëhet nga buxheti i Drejtorisë për Administratë.

3. Ftesa dhe agjenda për pjesëmarrje në trajnim është e bashkëngjitur në shtojcë të këtij vendimi.

4. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Buxhet dhe Financa.

5. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

6. Vendimi i dërgohet: Drejtorisë për buxhet dhe financa dhe arkivit të sekretarisë.

Kryetari i Komunës

Bajram Mulaku

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E VUSHTRRISË - OPŠTINA VUČITRN
Nr./Br. 724/16
Nr. i fq./Br. st. -1-
Data/Datum 21.07.2016
VUSHTRRI - VUČITRN

REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI

Kryetari

Bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 dhe nenin 67, "g" të Statutit të Komunës, si dhe në bazë të ftesës së BE – Këshilli i Evropës dt. 30.06.2016, Kryetari i Komunës merr këtë:

# V E N D I M

1. Znj. **Shpresa Rama**, Drejtoreshë për Kulturë Rini dhe Sport, caktohet zyrtar i komunës për aplikim në anëtarësimin e Komunës së Vushtrrisë në Organizatën Ndërkombëtare "Rrjeti i Qyteteve të Forta" si dhe merr pjesë në të gjitha aktivitetet e kësaj organizate, qëllimi i së cilës është krijimi i marrëdhënieve të partneritetit në mes të qyteteve të ndryshme të botës në parandalimin e akteve të terrorizmit.

2. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

3. Vendimi i dërgohet: Të lartëpërmendures dhe arkivit të sekretarisë.

Kryetari i Komunës

Bajram Mulaku

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E VUSHTRRISË-OPŠTINA VUČITRN
Nr. / Br. 729/16
Nr. i fq. / Br. st. -1-
Data: / Datum 22.07.2016
VUSHTRRI - VUČITRN

REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI

Kryetari

Bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 dhe nenin 67, "g" të Statutit të Komunës, Kryetari i Komunës merr këtë:

# VENDIM

1. Lejohet pagesa e faturës nr. 1075, dt. 20.07.2016 në shumë prej 2580 € (dymijepesqindetetëdhjet euro), për shpenzimet e krijuara në NH "Amazona", Muzakaj, Obiliq me rastin e mbajtjes se Konferencës Rajonale, organizuar nga Komuna e Vushtrrisë dhe Këshilli i Evropës, në temën: Pjesëmarrja e komuniteteve pakicë në procesin e vendimmarrjes".

2. Pagesa të bëhet në llogarinë bankare të paraqitur në faturë, nga mjetet e Këshillit të Evropës të derdhura në llogarinë bankare të komunës konform marrëveshjes së mirëkuptimit FIMS PO Nr. 500878, dt.07.04.2016 në mes të Komunës së Vushtrrisë dhe Këshillit të Evropës si dhe planit buxhetor PO 500878, dt.25.03.2016.

3. Marrëveshja dhe Plani buxhetorë janë pjesë e këtij vendimi dhe janë të bashkëngjitura në shtojcë.

4. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

5. Vendimi i dërgohet: Drejtorisë për buxhet dhe financa dhe arkivit të sekretarisë.

Kryetari i Komunës

Bajram Mulaku

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E VUSHTRRISË - OPŠTINA VUČITRN
01 Nr./Br. 733/16
Nr. i fq./Br. st. -3-
Data:/Datum 25.07.2016
VUSHTRRI - VUČITRN

REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI

Kryetari

Bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, nenin 22 paragrafi 2 pika 2.4 të Ligjit për Pagat e nëpunësve Civil nr.03/L-147 dhe nenin 22 paragrafi 2 të Rregullores së Qeverisë së Republikës së Kosovës për shtesat në pagë dhe kompensime të tjera të nëpunësve civil nr.33/2012, Kryetari i Komunës merr këtë:

# VENDIM

1. z. Sabri Xhaferi, zyrtar në Drejtorinë për Administratë në Komunën e Vushtrrisë, i lejohet pagesa e kompensimit në shumë prej 374,23 €, në emër të ndihmës monetare me rastin e vdekjes së anëtarit të familjes së tij të ngushtë (prindit).

2. Certifikata e vdekjes së anëtarit të ngushtë të familjes të të lartpërmendurit është e bashkëngjitur në shtojcë të këtij vendimi.

3. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për buxhet dhe financa.

4. Vendimi hyn ë fuqi në ditën e nënshkrimit.

5. Vendimi iu dërgohet: Drejtorisë Buxhet dhe Financa dhe Arkivit të Sekretarisë.

Kryetari i Komunës

Bajram Mulaku

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E VUSHTRRISË - OPŠTINA VUČITRN
02 Nr. / Br. 734/16
Nr. i Sp. / Br. sl. -1-
Data: / Datum 25.07.2016
VUSHTRRI - VUČITRN

REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI

Kryetari

Bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, nenin 22 paragrafi 2 pika 2.4 të Ligjit për Pagat e nëpunësve Civil nr.03/L-147 dhe nenin 22 paragrafi 2 të Rregullores së Qeverisë së Republikës së Kosovës për shtesat në pagë dhe kompensime të tjera të nëpunësve civil nr.33/2012, Kryetari i Komunës merr këtë:

# V E N D I M

1. z. Bislim Dushi, zyrtar në Zyrën e Kryetarit në Komunën e Vushtrrisë, i lejohet pagesa e kompensimit në shumë prej 374, 23 €, në emër të ndihmës monetare me rastin e vdekjes së anëtarit të familjes së tij të ngushtë (prindit).
2. Certifikata e vdekjes së anëtarit të ngushtë të familjes të të lartpërmendurit është e bashkëngjitur në shtojcë të këtij vendimi.
3. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për buxhet dhe financa.
4. Vendimi hyn ë fuqi në ditën e nënshkrimit.
5. Vendimi iu dërgohet: Drejtorisë Buxhet dhe Financa dhe Arkivit të Sekretarisë.

Kryetari i Komunës

Bajram Mulaku

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E VUSHTRRISË - OPŠTINA VUČITRN
03 Nr. / Br. 735/16
Nr. i fq. / Br. st. -1-
Data / Datum 25.07.2016
VUSHTRRI - VUČITRN

REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI

Kryetari

Bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, nenin 22 paragrafi 2 pika 2.4 të Ligjit për Pagat e nëpunësve Civil nr.03/L-147 dhe nenin 22 paragrafi 2 të Rregullores së Qeverisë së Republikës së Kosovës për shtesat në pagë dhe kompensime të tjera të nëpunësve civil nr.33/2012, Kryetari i Komunës merr këtë:

# VENDIM

1. z. Bekim Selmani, zyrtar në Drejtorinë për Administratë në Komunën e Vushtrrisë, i lejohet pagesa e kompensimit në shumë prej 374,23 €, në emër të ndihmës monetare me rastin e vdekjes së anëtarit të familjes së tij të ngushtë (prindit).
2. Certifikata e vdekjes së anëtarit të ngushtë të familjes të të lartpërmendurit është e bashkëngjitur në shtojcë të këtij vendimi.
3. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për buxhet dhe financa.
4. Vendimi hyn ë fuqi në ditën e nënshkrimit.
5. Vendimi iu dërgohet: Drejtorisë Buxhet dhe Financa dhe Arkivit të Sekretarisë.

Kryetari i Komunës

Bajram Mulaku

743/16
-02-
27.07.2016
VUSHTRRI - VUČITRN

REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI

Bazuar në nenin 1 dhe 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 dhe nenin 4 paragrafi 2. pika 2.4. nënpika 2.4.3. nenit 7 paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme. Nr. 03/L-139 me ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit Nr.03/L-205 të datës 28.10.2010. si dhe nenit 67 "g" të Statutit të Komunës. si dhe bazuar në vendimin e kuvendit të komunës 01Nr.190/14 dt.29.09.2014. listën e projekteve kapitale për v. 2015 të miratuar në mbledhje të KK-së me datën 29.09.2014. Kryetari i Komunës si organi shpronësues me datën 28.07.2016 merr këtë:

## V E N D I M
## PËR FILLIMIN E PROCEDURËS PËR SHPRONËSIM TË PRONAVE TË PALUEJTSHME

### Neni 1

Fillohet procedura e shpronësimit të pronave të paluejtshme të pronarëve privat/ zotëruesit të interesit. për qëllim të interesit publik – realizimi i projektit për asfaltimin e rrugës lokale në Lagjen "Igrishta" në fshatin Stanoc i Poshtëm. Komuna Vushtrri, për pjesën e parcelave kadastrale si në vijim:

- P-70202053-00207-0. në sipërfaqe prej **30 m²**. nga sipërfaqja e përgjithshme prej 1663 m². ZK-Prelluzhë. pronar në pjesë ideale 1/1 Sefedin Rexhep Haradini nga Stanoci i Poshtëm. Komuna Vushtrri.
- P-70202053-00208-0. në sipërfaqe prej **10m²**. nga sipërfaqja e përgjithshme prej 1409 m². ZK-Prelluzhë pronar me pjesë ideale 1/1 Izet Brahim Igrishta nga Stanoci i Poshtëm. Komuna Vushtrri.

### Neni 2

Shpronësimi i pjesëve të parcelave kadstrale të cekura në pikën 1 të këtij vendimi bëhet me kompensim. konform dispozitave të Ligjit për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme.

### Neni 3

Vlerësimin për kompensimin e shpronësimit e bën Zyra për Vlerësim të Pronës së paluajtshme pranë Ministrisë së Financave të Kosovës.

**Neni 4**

Me këtë vendim të njoftohet Drejtoria për Gjeodezi dhe Kadastër, Drejtoria e Urbanizmit, dhe Drejtoria për Buxhet dhe Financa si dhe pronarët/zotëruesit e interesit të parcelave që do të shpronësohen.

**Neni 5**

Vendimi hyn ne fuqi në ditën e nënshkrimit nga organi shpronësues.

Kryetari i Komunës

Bajram Mulaku

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E VUSHTRRISË - OPŠTINA VUČITRN
02 Nr. / Br 747/16
Nr. i fq. / Br. st -1-
Datë / Datum 29.07.2016
VUSHTRRI - VUČITRN

REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI

Kryetari

Bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, nenin 22 paragrafi 2 pika 2.4 të Ligjit për Pagat e nëpunësve Civil nr.03/L-147 dhe nenin 22 paragrafi 1 të Rregullores së Qeverisë së Republikës së Kosovës për shtesat në pagë dhe kompensime të tjera të nëpunësve civil nr.33/2012, Kryetari i Komunës merr këtë:

# VENDIM

1. znj. Nurije Hyseni, bashkëshorte e të ndjerit Xhavit Hyseni, ish zyrtar në Drejtorinë për Administratë në Komunën e Vushtrrisë, i lejohet pagesa e kompensimit në shumë prej 349.04 €, në emër të ndihmës monetare me rastin e vdekjes së anëtarit të familjes së ngushtë - bashkëshortit (një pagë mujore e tij).
2. Certifikata e vdekjes së bashkëshortit dhe certifikata e martesës, janë të bashkëngjitura në shtojcë të këtij vendimi.
3. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për buxhet dhe financa.
4. Vendimi hyn ë fuqi në ditën e nënshkrimit.
5. Vendimi iu dërgohet: Drejtorisë Buxhet dhe Financa dhe Arkivit të Sekretarisë.

Kryetari i Komunës

Bajram Mulaku

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E VUSHTRRISË-OPŠTINA VUČITRN
01 Nr./Br. 748/16
Nr.Fq./Str.br. -1-
Data:/Datum 29.07.2016
VUSHTRRI - VUČITRN

REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI

Kryetari

Bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 dhe nenin 67, "g" të Statutit të Komunës, Kryetari i Komunës merr këtë:

VENDIM

1. Znj. **Vlora Mehmeti**, asistente administrative e Kryetarit të Komunës caktohet zyrtare për pranim të gazetave ditore me të cilat furnizohet stafi udhëheqës i komunës.

2. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

3. Vendimi i dërgohet: Drejtorisë për buxhet dhe financa dhe arkivit të sekretarisë.

Kryetari i Komunës

Bajram Mulaku

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E VUSHTRRISË-OPŠTINA VUČITERN
Nr./Br. 749/16
Nr.i faq./Br.st. -3-
Data:/Datum 29.07.2016
VUSHTRRI - VUČITERN

REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI

Kryetari

Bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 dhe nenin 67, "g" të Statutit të Komunës, Kryetari i Komunës merr këtë:

# V E N D I M

1. Z. Shefqet Kurti me banim në Vushtrri, i lejohet ndihmë financiare në shumë prej 350 (treqindepesdhjetë euro) në emër të ndihmës për ceremoninë e varrimit dhe pritjes së ngushëllimeve me rastin e vdekjes së vëllait të tij, të ndjerit Ismet Kurti, veteran i luftës së UÇK-së.

2. Pagesa e mjeteve në shumën e cekur në pikën paraprake të këtij vendimi të bëhet nga buxheti i zyrës së kryetarit të komunës, kategoria subvencione dhe transfere – subvencione për raste të veçanta.

3. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

4. Vendimi i dërgohet: Drejtorisë për buxhet dhe financa dhe arkivit të sekretarisë.

Kryetari i Komunës

Bajram Mulaku